

## **FLETEPALOSJE PËR PACIENTIN**

Si vizitor në United Kingdom, mund t'ju kërkohet të paguani për trajtimin e kujdesit shëndetsor sekondar të financuar nga NHS. Kjo aplikohet pa patur parasysh kombësinë duke patur një numër NHS apo duke qënë i regjistruar në një praktikë të GP, edhe pse jeni ish rezident në UK apo taksëpagues. Është përgjegjësia juaj të demonstroi që keni të drejtë për këtë trajtim duke paraqitur prova dokumentuese para marrjes së çdo trajtimi. Kjo provë duhet paraqitur edhe nëqoftëse:

- i. Ju e keni paguar mbitaksën shëndetsore të imigracionit dhe keni një vizë të vlefshme që mbulon kohëzgjatjen e trajtimit.
- ii. keni kartë të vlefshme jo UK për Sigurimin Shëndetsor European, modeli S1 ose S2;
- iii. bëni pjesë në një kategori tjetër përjashtimi, të parashikuar në Rregullore; ose,
- iv. keni një sigurim shëndeti/udhëtimi, të përshtatshëm për të mbuluar nevojat tuaja shëndetsore

Nëqoftëse mendoni se nuk jeni vizitor në UK por jeni këtu rezident i zakonshëm, ju duhet gjithashtu të paraqitni prova dokumentuese në mbështetje të këtij fakti.

Provat dokumentuese do të përdoren për të përcaktuar përshtatshmërinë tuaj për trajtimin e kujdesit shëndetsor sekondar të financuar nga NHS. Nëqoftëse nuk paraqitni prova të kënaqshme për të mbështetur kërkesën tuaj që keni të drejtë për trajtimin e kujdesit shëndetsor sekondar të financuar nga NHS, do të jeni përgjegjës për koston e çdo trajtimi që do të merrni.

## **Vizitorë nga vendet e EEA**

Nëqoftëse jeni vizitor ose student nga Zona Ekonomike Europiane (EEA) dhe kërkon trajtim mjekësor, duhet të paraqitni një kartë të vlefshme jo UK të Sigurimit Shëndetsor Evropian (EHIC) për t'u siguruar që nuk keni detyrim për kujdesin shëndetsor tuaj.

EHIC juaj do ju mbulojë gjithë trajtimin e nevojshëm mjekësor gjatë qëndrimit tuaj edhe pse duhet të keni parasysh që sistemi i kujdesit shëndetsor në UK mund të jetë i ndryshëm nga ai i vendit tuaj, kështu që EHIC juaj mund të mos mbulojë gjithçka që në vendin tuaj parashikohet pa pagesë.

Duhet gjithashtu të jeni i vetëdijshëm që EHIC nuk është alternativë e sigurimit të udhëtimit dhe nuk do të mbulojë çfaredo lloj kujdesi shëndetsor privat ose kthimin në vendin tuaj, apo vjedhjen e humbjen e pronës. Po ashtu, trajtimi i planifikuar nuk mbulohet nga EHIC edhe po nuk keni dokumentacion të vlefshëm (modeli 'S2') do t'ju duhet të paguani për trajtimin.

## **Si mund të vlerësohet përshtatshmëria juaj**

Çdo xhestor i kujdesit shëndetsor sekondar të financuar nga NHS në UK duhet të kontrollojë gjithë pacientët për përshtatshmërinë e tyre lidhur me trajtimin e financuar nga NHS.

Kjo realizohet duke vlerësuar nëse pacienti është rezident i zakonshëm në UK apo, nëse jo, kur për ta aplikohet një përjashtim nga kategoria e pagesës. Prandaj duhet të jeni i përgatitur të paraqitni prova për të demonstruar përshtatshmërinë tuaj për kujdesin shëndetsor sekondar të financuar nga NHS, që mund të bëhet duke paraqitur kopje të:

- i. Të paktën një dokument me fotografinë tuaj (pasaportë/kartë identiteti kombëtar/ Leje Rezidence Biometrike UK/ Patentë automjeti); dhe
- ii. Të paktën një dokument për të provuar ku banoni (fatura për shërbimet publike apo fatura e Këshillit Fiscal; Deklaratë bankare apo shoqërie ndërtimi apo kontratë qiraje)

Edhe pse mund të jeni regjistruar në një GP dhe mund të merrni shërbime kujdesi shëndetsor primar NHS pa pagesë, kjo nuk do të thotë që ju të keni të drejtë për trajtim kujdesi shëndetsor sekondar të financuar nga NHS, edhe pse GP të drejton për këtë.

Në qoftë se jeni në UK për një qëndrim të përkohshëm prej më shumë se 6 muaj, dhe e keni paguar Mbitaksën Shëndetsore të Imigracionit në momentin e aplikimit të vizës, ju do të merrni shërbim NHS pa pagesë për sa kohë që leja juaj e qëndrimit do të jetë e vlefshme, me përjashtim të shërbimeve dhe detyrimeve me konceptim të asistuar që rezidentet duhet të paguajnë, për shëmbull receta ilaçesh në Angli.

Në qoftë se nuk jeni rezident në UK por jeni të përjashtuar nga pagesat, për shëmbull jeni nga një vend që ka një akord reciprok për shërbimin shëndetsor me UK, si Australia, do t'ju duhet që, për këtë të paraqitni prova.

## **Shërbime pa pagesë për të gjithë**

Disa shërbime apo trajtime të kryera në një spital NHS janë pa pagesë për gjithë njerëzit. Këto përfshijnë:

- aksident dhe shërbime emergjence (pa përfshirë trajtim emergjence kur jeni shtruar në spital)
- shërbime planifikimi për familjen (nuk përfshijnë fundin e shtatzanisë)
- diagnozë dhe, nëse pozitive, trajtim për shumicën e sëmundjeve infektive, duke përfshirë infeksionet e transmetueshme seksualisht.

- trajtim i kërkuar për një gjëndje fizike apo mentale shkaktuar nga tortura, gjymtim gjenital femëror, dhunë shtëpiake apo dhunë seksuale (kjo nuk aplikohet në qoftë se keni ardhur në UK me qëllimin që të kërkonit këtë trajtim).

Disa kategori pacientësh janë të përjashtuara nga pagesa, përfshirë çdo gjëndje të shkaktuar nga disa tipe dhune (tortura, gjymtimi gjenital femëror, dhuna shtëpiake, dhuna seksuale). Një listë të plotë të përjashtimeve mund ta gjeni në faqen Gov.UK :

<https://www.gov.uk/government/publications/guidance-on-overseas-visitors-hospital-charging-regulations/summary-of-changes-made-to-the-way-the-nhs-charges-overseas-visitors-for-nhs-hospital-care>

### **Trajtimi i nevojshëm i menjëhershëm dhe shërbimet e maternitetit**

Në qoftë se trajtimi që keni kërkuar është konsideruar I menjëhershëm apo urgjent prej mjekut, ky trajtim nuk do ju mohohet dhe do kryhet pa vonesë, edhe pse do t'ju duhet të paguani për trajtimin në se nuk hyni në asnjë kategori përjashtimi. Në qoftë se nuk paguani përpara trajtimit, shpenzimet do të llogariten pas trajtimit dhe do ju kërkohet të paguani.

Gjithë shërbimet e maternitetit - përfshirë trajtimin para lindjes - shihen si trajtim i nevojshëm I menjëhershëm. Në qoftë se ju kërkonit çdo shërbim materniteti, do t'ju jepet por do t'ju kërkohet të paguani më pas shpenzimet eventuale në qoftë se ju nuk bëni pjesë në asnjë kategori përjashtimi.

### **Pagesa për trajtim**

Nëqoftëse ju duhet të paguani për trajtimin tuaj, do të merrni një faturë dhe do t'ju kërkohej të paguani koston e plotë të trajtimit spitalor tuaj. Kjo faturë do të llogaritet bazuar në trajtimin e parashikuar. Pavarësisht nga kjo, në qoftë se kostoja përfundimtare e trajtimit është e ndryshme nga kostoja e parashikuar do t'ju kthehen lekët që ju takojnë ose do bëhen ngarkesa shtesë për të mbuluar koston më të lartë të trajtimit.

Duhet të keni të qartë se kur kujdesi shëndetsor NHS ju është dhënë para pagesës (për shëmbull sepse ka qënë vlerësuar prej një mjeku si i menjëhershëm apo urgjente, dhe nuk ka qënë e duhur apo e mundur të prokurohej pagesa paradhenie) do ju kërkohej të paguani më pas.

Mund të paguani për trajtimin me kartë krediti/debiti, transferta bankare, kesh ose me debi direkte.

### **Mospagesa për trajtimin**

Në qoftë se nuk paguani për trajtimin që keni marrë, do të thotë se një kerkesë e ardhëshme për një vizë do t'ju kthehet mbrapsh. Gjithmonë të siguroheni që keni sigurimin e duhur për udhëtim, në gjëndje të mbulojë nevoja shëndetsore të paparashikuara gjatë qëndrimit tuaj. Duhet të diskutoni me spitalin në qoftë se keni vështirësi për të paguarçdo debit.

Overseas Visitors Manager  
Southside  
James Paget University Hospital NHS Foundation Trust  
Lowestoft Road  
Gorleston  
Great Yarmouth  
Norfolk  
NR31 6LA

E mail: [overseas.visitors@jpaget.nhs.uk](mailto:overseas.visitors@jpaget.nhs.uk)